E nderuara Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Zonja Haxhiu,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kam kënaqësinë dhe nderin që sot, para jush të prezantoj Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2025, i cili pasqyron rezultatet e punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe ofron një vlerësim të pavarur për mënyrën se si janë menaxhuar fondet publike.

Para se të ndalem te rezultatet e raportit, më lejoni t'ju përgëzoj për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe marrjen e mandatit tuaj si përfaqësues të qytetarëve.

Ky mandat përfaqëson besimin e qytetarëve dhe një përgjegjësi të veçantë për të mbrojtur interesin publik, për të forcuar institucionet demokratike dhe për të kontribuar në zhvillimin e vendit.

Funksionaliteti i Kuvendit është veçanërisht i rëndësishëm për mbikëqyrjen e financave publike. Në këtë kuptim, shqyrtimi i Raportit Vjetor të Auditimit është më shumë se një detyrim institucional. Ai është një mekanizëm i rëndësishëm për transparencë, llogaridhënie dhe përmirësimin e qeverisjes publike.

Dëshiroj gjithashtu të shpreh mirënjohjen time për Kuvendin për besimin e dhënë për vazhdimin e mandatit tim si Auditore e Përgjithshme. E konsideroj këtë besim nder të veçantë dhe përgjegjësi të shtuar ndaj Kuvendit dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Mbetem e përkushtuar që këtë përgjegjësi ta ushtroj përmes udhëheqjes së një institucioni të pavarur, profesional dhe të paanshëm, në shërbim të interesit publik.

Të nderuar deputetë,

Raporti që po prezantoj sot përmban dy shtylla kryesore.

Shtylla e parë është auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, i cili përfshin opinionin e

auditimit, gjetjet kryesore dhe rekomandimet për përmirësimin e raportimit financiar dhe menaxhimit të buxhetit.

Shtylla e dytë përfshin rezultatet e auditimeve individuale të institucioneve publike, përkatësisht auditimet financiare dhe të pajtueshmërisë në organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, auditimet e veçanta të pajtueshmërisë, auditimet e performancës dhe auditimet e projekteve të financuara nga Banka Botërore.

Në tërësi, rezultatet tregojnë se ka pasur përmirësime në disa fusha, por vazhdojnë të jenë të pranishme mangësi që kërkojnë ndërhyrje dhe përgjegjësi më të madhe institucionale.

2. Opinioni i auditimit për Raportin Vjetor Financiar të Qeverisë

Nga auditimi i Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë për vitin 2025, kemi vlerësuar se cilësia e raportimit financiar ka shënuar përmirësime ndër vite dhe se raportimi është në përputhje me standardet dhe kornizën ligjore përkatëse në aspektet e vlerësuara.

Megjithatë, në bazë të rezultateve të auditimit, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë opinion të kualifikuar.

Ky opinion nënkupton se, përveç ndikimit të çështjeve të paraqitura në bazën për opinionin e kualifikuar, Raporti Vjetor Financiar paraqet një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën përkatëse të raportimit financiar.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në këtë opinion lidhen me klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve, pasuritë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet e raportuara.

Së pari, është evidentuar klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në vlerë prej 77.4 milionë euro. Prej kësaj shume, 58.5 milionë euro lidhen me pagesat e realizuara në bazë të vendimeve gjyqësore, nga kategori jo adekuate buxhetore, kryesisht për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontratat kolektive në nivel komunal.

Kjo ka ndodhur përkundër mundësisë së krijuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për planifikimin e mjeteve në kategorinë e rezervave, me qëllim të shmangies së klasifikimit jo të duhur të këtyre shpenzimeve.

Pjesa tjetër përfshin buxhetimin jo adekuat në vlerë prej mbi 4.5 milionë euro dhe keqklasifikimet e shkaktuara nga vetë organizatat buxhetore në vlerë prej 14.4 milionë euro.

Së dyti, është evidentuar mbivlerësimi i pasurive në vlerë prej rreth 33.5 milionë euro.

Së treti, janë identifikuar mangësi në raportimin e zërave të tjerë financiarë, përfshirë nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 4.4 milionë euro, mbivlerësimin e detyrimeve të papaguara në vlerë prej 2.8 milionë euro dhe mbivlerësimin e detyrimeve kontingjente në vlerë prej afër 30 milionë euro.

Këto çështje tregojnë se, krahas përmirësimeve të arritura, nevojitet forcim i mëtejshëm i kontrolleve të brendshme, saktësim i evidencave kontabël dhe përmirësim i disiplinës së raportimit financiar.

Përtej opinionit të auditimit, raporti ofron një pasqyrë të rëndësishme të realizimit të buxhetit dhe gjendjes së financave publike gjatë vitit 2025.

Të hyrat buxhetore kanë arritur në mbi 3 miliardë e 512 milionë euro, krahasuar me vitin 2024, ato janë rritur për 278 milionë euro, ose rreth 9%.

Ndërkohë, shpenzimet buxhetore janë rritur për rreth 291 milionë euro, ose 9% krahasuar me vitin paraprak. Nga buxheti final prej rreth 3 miliardë e 848 milionë euro, janë realizuar 91%.

Sa i përket deficitit buxhetor, kufiri i përcaktuar me ligj është respektuar. Deficiti i planifikuar ishte 224 milionë euro, ose rreth 2% e Bruto Produktit Vendor (BPV), ndërsa deficiti sipas realizimit përfundimtar të buxhetit ishte rreth 7.8 milionë euro, ose 0.07% e BPV-së.

Borxhi i përgjithshëm shtetëror në fund të vitit 2025 arriti në mbi 1.8 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 80.4 milionë euro apo 4.6% krahasuar me vitin paraprak. Në raport me BPV-në, borxhi shtetëror ishte rreth 16.5%, pra brenda kufirit ligjor prej 40%.

Këta tregues pasqyrojnë respektimin e kufirit ligjor të deficitit dhe një nivel relativisht të ulët të borxhit shtetëror në raport me BPV-në. Megjithatë, qëndrueshmëria fiskale nuk duhet të vlerësohet vetëm përmes nivelit të borxhit dhe deficitit, por edhe përmes mënyrës se si përdoren burimet financiare dhe rezultateve që arrihen nga investimet publike.

Në këtë drejtim, një çështje që vazhdon të kërkojë vëmendje është niveli i tërheqjes së fondeve nga kreditë e jashtme.

Gjatë vitit 2025, organizatat buxhetore kanë tërhequr rreth 147.6 milionë euro nga kreditë për financimin e projekteve. Vonesat në zbatimin e projekteve janë shkaktuar kryesisht nga planifikimi i dobët, proceset e shpronësimit, ndryshimet e çmimeve në treg dhe kapacitetet e kufizuara institucionale për realizimin me kohë të projekteve.

Për këto çështje që lidhen me auditimin e Raportit Vjetor Financiar të Qeverisë, ZKA-ja ka dhënë gjithsej 17 rekomandime për Qeverinë dhe Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Të nderuar deputetë,

Gjatë sezonit të auditimit 2025–2026, Zyra Kombëtare e Auditimit ka realizuar gjithsej 131 auditime, duke mbuluar institucione publike, projekte dhe fusha me rëndësi për qytetarët.

Prej tyre: 99 janë auditime financiare dhe të pajtueshmërisë në organizata buxhetore dhe ndërmarrje publike;

- 15 janë auditime të performancës;
- 11 janë auditime të veçanta të pajtueshmërisë;
- 6 janë auditime të projekteve të Bankës Botërore.

Rezultatet e auditimeve financiare tregojnë se nga organizatat buxhetore të audituara, 37 kanë marrë opinion të pamodifikuar, ndërsa 57 kanë marrë opinion të kualifikuar.

Në ndërmarrjet publike të audituara, të gjitha kanë marrë opinione të modifikuara dhe pesë prej tyre kanë marrë opinion të kundërt.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin, 31 raporte të auditimit kanë rezultuar me konkluzione të pamodifikuara, 62 me konkluzione të kualifikuara dhe katër me konkluzione të kundërta.

Konkluzionet e kundërta janë dhënë për Komunën e Prishtinës, ndërmarrjen publike "Trepça", KRM "Pastërtia" dhe NPL "Stacioni i Autobusëve" Prishtinë.

Këto rezultate tregojnë se sfidat në raportimin financiar dhe respektimin e kërkesave ligjore vazhdojnë të jenë të pranishme në një numër të konsiderueshëm të institucioneve publike.

Çështjet kryesore që kanë ndikuar në konkluzionet e modifikuara përfshijnë:

- dobësitë në menaxhimin e kontratave publike;
- hyrjen në obligime pa fonde të mjaftueshme;
- parregullsitë në prokurimin publik;
- vonesat në pagesën e faturave;
- mangësitë në menaxhimin e subvencioneve;
- problemet në menaxhimin e burimeve njerëzore;
- administrimin joefektiv të pronave publike.

Dëshiroj të veçoj dy çështje që kanë rëndësi të veçantë për disiplinën buxhetore dhe menaxhimin e parasë publike.

E para është lidhja e kontratave për projekte kapitale pa siguruar paraprakisht fondet e nevojshme ose pa marrë miratimet përkatëse. Vlera e

obligimeve kontraktuale vetëm në katër komuna pa mbulesë buxhetore ishte 19 milionë euro. Si dhe në gjashtë (6) komuna, janë evidentuar 82 pagesa për projekte në vlerë të përbashkët afër 12 milionë euro ku fondet e dedikuara për projekte specifike janë përdorur për qëllime të tjera nga ato për të cilat ishin planifikuar.

Kjo praktikë krijon rrezik për qëndrueshmërinë buxhetore, mund të shkaktojë detyrime të paplanifikuara dhe kufizon mundësinë e institucioneve për t'i përmbushur obligimet e tyre brenda afateve ligjore.

E dyta është menaxhimi i kontratave publike si në nivel qendror ashtu edhe atë lokal. Mangësitë në monitorimin e zbatimit të kontratave, mos aplikimi i penaliteteve kur ato janë të zbatueshme, ndryshimet pa miratimet e nevojshme dhe dokumentimi i pamjaftueshëm mund të ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e punëve dhe shërbimeve, koston e projekteve dhe përmbushjen e objektivave të kontraktuara.

Këto janë çështje që kërkojnë përgjegjësi të qartë nga menaxherët e kontratave, zyrtarët përgjegjës dhe menaxhmentet e institucioneve.

Një pjesë e rëndësishme e auditimeve tona ka mbuluar edhe ndërmarrjet publike me rëndësi për ekonominë dhe ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë Trepçën, KEK-un, KOSTT-in, Termokos-in dhe ndërmarrje të tjera.

Rezultatet tregojnë se menaxhimi financiar dhe qëndrueshmëria e disa prej këtyre ndërmarrjeve vazhdojnë të kërkojnë vëmendje të shtuar. Për këtë arsye, përgjegjshmëria e bordeve dhe menaxhmenteve, cilësia e vendimmarrjes dhe transparenca në përdorimin e burimeve janë thelbësore.

Të nderuar deputetë,

Një dimension i rëndësishëm i punës së ZKA-së janë auditimet e performancës, përmes të cilave vlerësojmë nëse programet, projektet dhe shërbimet publike po i arrijnë rezultatet e synuara dhe nëse burimet publike po përdoren në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Gjatë këtij sezoni, auditimet kanë mbuluar fusha të ndryshme, përfshirë arsimin, sigurinë e nxënësve, mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta, zhvillimin urban, shërbimet publike, energjinë, pronat dhe teknologjinë e informacionit.

Në fushën e arsimit, auditimi për sigurinë e nxënësve në shkollat publike ka nxjerre në pah se institucionet përgjegjëse nuk funksionojnë ende si një sistem i koordinuar, i standardizuar dhe efektiv për garantimin e sigurisë së nxënësve në shkolla. Këto mangësi kanë bërë që reagimi ndaj rasteve të jetë shpesh reaktiv dhe jo i bazuar në menaxhim sistematik të rrezikut dhe dhunës në shkolla.

Auditimi për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta ka evidentuar se sistemi arsimor ende nuk siguron mbështetje të barabartë dhe të bazuar në nevojat reale. Kapacitete të pamjaftueshme profesionale, mosfunksionim i ekipeve vlerësuese komunale, mungesa e procedurave të standardizuara dhe monitorim i pamjaftueshëm nga niveli qendror.

Në fushën e zhvillimit urban, auditimi i procesit të ndërtimeve të larta në komunën e Fushë Kosovës dhe komunën e Ferizajt ka evidentuar mangësi në dhënien e lejeve të ndërtimit dhe nevojën për kontrolle e mbikëqyrje më efektive gjatë proceseve të lejeve, ndërtimit dhe certifikimit. Mungesa e Planit Zhvillimor Komunal, planeve rregulluese të hollësishme, dobësitë në zbatimin e Hartës Zonale, numri i ulët i inspektimeve, kontrollet e pamjaftueshme në fazat e lejeve dhe certifikatave të përdorimit kanë rezultuar me tejkalime të parametrave urbanistikë, mungesë të vendparkimeve jashtë kërkesave dhe vonesa në lëshimin e certifikatave.

Auditimet në fushën e shërbimeve publike, përfshirë ngrohjen qendrore në Termokos ka treguar se Termokosi përballet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin e sistemit të ngrohjes qendrore, të cilat lidhen me mangësi në menaxhimin teknik të rrjetit, dobësi në sistemin e matjes dhe faturimit, si dhe mungesë të sigurisë rezervë për furnizim.

Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të jetë as efikase dhe as efektive në grumbullimin e mbeturinave gjatë viteve të fundit. Situata e rënduar e mbeturinave në kryeqytet, e reflektuar përmes mbingarkimit të kontejnerëve dhe shpërndarjes së mbeturinave nëpër trotuare dhe hapësira publike, paraqet dëshmi të dukshme që shërbimi i mbledhjes së mbeturinave nuk ka qenë adekuat.

Rezultatet e auditimit tregojnë se Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit nuk ka arritur të sigurojë që procesi i prokurimit për mirëmbajtjen e autoudhëve të realizohet plotësisht në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit, trajtimit të barabartë dhe jodiskriminimit të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Komuna e Malishevës në projektin "Ndërtimi i sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor" kishte filluar këtë projekt me vetëm 2.03 milionë euro për tri vite, ndërkohë që ishte nënshkruar kontratë me vlerë 8.28 milionë euro, në mungesë të planifikimit të detajuar, ndryshime në punime dhe materiale ndërtimore, dhe puna shtesë, kanë ndikuar në rritjen e kostos së projektit dhe në vonesa në realizim.

Në fushën e teknologjisë së informacionit, kemi evidentuar mangësi në integrimin e sistemeve, kontrollet e aplikacioneve, sigurinë e informacionit dhe menaxhimin e qasjes në të dhëna. Për shembull, Sistemi i Integruar Informativ për Skemat Pensionale ende nuk siguron integrim të plotë të të dhënave dhe shërbime plotësisht të digjitalizuara në kohë reale. Ndërsa Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve në Universitetin e Prishtinës ka mangësi në qeverisjen e teknologjisë së informacionit, kontrollin e qasjes dhe vazhdimësinë e shërbimeve.

Këto gjetje janë veçanërisht të rëndësishme në kohën kur institucionet po investojnë gjithnjë e më shumë në digjitalizim. Investimet në teknologji duhet të shoqërohen me siguri të informacionit, integrim të të dhënave, përgjegjësi të përcaktuara dhe kontrolle efektive.

E nderuara Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj të ndalem te një çështje që, sipas vlerësimit tonë, është ndër më të rëndësishmet për rritjen e ndikimit të auditimit publik: zbatimi i rekomandimeve.

Gjatë vitit 2025, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë gjithsej 1,032 rekomandime për përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe funksionimit të institucioneve. Megjithatë, nga rekomandimet e dhëna në vitin 2024, janë zbatuar vetëm 36%.

Ky nivel i zbatimit tregon se rekomandimet e auditimit ende nuk po marrin vëmendjen dhe veprimin e nevojshëm nga një pjesë e institucioneve përgjegjëse. Kur rekomandimet nuk zbatohen, mangësitë vazhdojnë të përsëriten, rreziqet mbeten të pranishme dhe mundësia për të përmirësuar menaxhimin e parasë publike kufizohet.

Në këtë proces, Kuvendi ka një rol të rëndësishëm përmes shqyrtimit sistematik të raporteve të auditimit, kërkimit të llogarisë nga institucionet përgjegjëse dhe përcjelljes së masave konkrete për adresimin e gjetjeve.

Një mbikëqyrje më e strukturuar parlamentare, veçanërisht për rekomandimet me rrezik të lartë dhe ato që përsëriten ndër vite, do të kontribuonte në rritjen e përgjegjësisë institucionale dhe në përmirësimin e rezultateve.

Si Auditore e Përgjithshme, mbetem e përkushtuar që Zyra Kombëtare e Auditimit të vazhdojë ta ushtrojë mandatin e saj me pavarësi, profesionalizëm, integritet dhe transparencë, duke kontribuar në forcimin e llogaridhënies dhe në përdorimin e përgjegjshëm të parasë publike.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe ju uroj suksese në përmbushjen e mandatit tuaj në shërbim të qytetarëve dhe të Republikës së Kosovës.